



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **26**

Prishtinë, më 25.9.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Srđan Mitrović, Salih Zyba, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Andin Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 18.9.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.9. 2018

Kryetari i komisionit konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018, **Salih Zyba** abstenoj për shkak se ka munguar në mbledhjen e kaluar.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Kryetari Muharrem Nitaj, fillimisht tha se Projektligji i ri është bërë me qëllim të përshtatjes me direktivat e reja të BE-së dhe pastaj përmendi disa konstatime nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën : Kosova është në fazën e hershme të përgatitjes në fushën e mjedisit; problemet serioze mjedisore vazhdojnë të ndikojnë në jetesën dhe shëndetin e popullatës; cilësia e ajrit sidomos në zonat urbane, vazhdon të përbëjë kërcënim madhor ndaj shëndetit publik; Strategjia dhe ligji për cilësinë e ajrit vazhdojnë të mos ekzekutohen, etj. dhe ia kaloi fjalën përfaqësuesit të MMPH-së për prezantimin e elementeve kryesore të projektligjit.

Nezakete Hakaj nga MMPH, njoftoi se është hera e dytë që ministria e bën ndryshimin e këtij ligji duke marrë parasysh ndryshimin e direktivave të BE-së por edhe për shkak të pengesave që janë paraqitë gjatë implementimit, prandaj ligji i ri është bërë për shkak të pëmbushjes së këtyre obligimeve por duke iu përshtatë kushteve tona të zhvillimit ekonomik dhe social. Projektligji përmban 17 kapituj dhe 69 nene dhe i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e cilësisë së ajrit, gjithashtu do të definohen më qartë përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe komunave. Në pyetjen e **Kryetarit**, në cilat pjesë harmonizohet ligji me direktivat e BE-së, **Nezakete Hakaj**, iu përgjigj se direktiva e BE-së për ajrin vazhdimisht ndryshon dhe tani kemi direktivën e 4 të sajë dhe ky ligj prek gati tërë substancën e ligjit paraprak.

Ganimete Musliu tha se sot po ndodh një praktikë e re e shqyrtimit të projektligjeve dhe sugjeroi për formimin e grupit punues fillimisht pasi që ky grup do të rekomandoi komisionit për të miratuar apo jo ky projektligj në parim, megjithëse edhe rekomandimi për leximin e parë nuk do të ishte gabim, pasi që në mes dy leximeve do të trajtohet në grupin punues.

Besa Gaxherri, tha kjo që u ngrit është një çështje teknike se nuk ka asgjë të keqe dhe konsideroj se kjo fushë kërkon ekspertizë profesionale, deputetët kanë përgjegjësi ta shqyrtojnë nen për nen, ky ligj është i domosdoshëm dhe ajo shpresoj se do të ndikojë në ndryshimin e cilësisë së ajrit, por fillimisht duhet të kaloj në parim.

Gjatë diskutimeve për formimin e grupit punues apo jo, lindi polemika (**Kryetari, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Salih Zyba, Lutfi Zharku**) rreth deklaramentit të Besa Gaxherrit që LDK nuk voton në Komision dhe nuk jap anëtar për grupe punuese por deklarohet në mbledhje plenare, megjithatë komisioni shprehu mirëkuptimin rreth kësaj sepse është e drejt sipas rregullores së Kuvendit, përkundër abstenimit të LDK dhe LVV për të votuar në komision.

Salih Salihu potencoi se kemi të bëjmë me një ligj të rëndësishëm që prek shëndetin e popullatës, dhe pasi për bazë i ka problemet që janë më ndotjen e ajrit, është mirë mos të votohet tash, por të formohet një grup punues së pari, gjithashtu shprehu habinë pse ndodhë kjo me dy parti, ngase gjithmonë në këtë komision është punuar bashkërisht dhe unik.

Salih Zyba qartësoi se asnjë praktikë e re nuk ka nevojë të formohet ngase ekzistojnë në Rregullore dhe në Kushtetutë, por pasi që ligji ka ndryshuar mjaft dhe anëtarët e komisionit nuk kanë pas kohë të mjaftueshme për konsultime me ekspertë, nuk duhet të votohet në këtë mbledhje.

Kryetari pyeti anëtarët e komisionit a janë dakord të formohet ky grup i punës.

Besa Gaxherri, tha se LDK nuk do të jetë pjesë e Grupit të punës dhe nuk do të voton në Komision, por në Kuvend do ta japin kontributin, ndërsa **Lutfi Zharku** e arsyetoi këtë për shkak të keqinterpretimit të votimit në Komision dhe Seancë siç ishte herën e kaluar. **Kryetari Muharrem Nitaj**, përmbylli këtë me konstatimin se çdo Grup parlamentar apo Parti politike kanë drejt të mbajnë qëndrimet politike si në komisione ashtu edhe në mbledhjet plenare.

Komisioni me 6 vota për, nxori :

P Ë R F U N D I M

Formohet Grupi punues për të dhënë rekomandimin Komisionit rreth leximit të parë të këtij projektligji: Salih Salihu-Kryesues, Ganimete Musliu, Etem Arifi, Muharrem Nitaj, anëtarë.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018

Kryetari Muharrem Nitaj pas raportit të miratuar në mbledhjen e kaluar për punën e suksesshme të komisionit në sesionin pranveror, përsëriti disa qëndrime të Komisionit nga mbledhja e kaluar për sesionin vjeshtor, për të vazhduar se ato kanë qenë në favor të asaj që sot komisioni të vendos për këtë plan vjeshtorë, qoftë edhe me të drejtën për plotësime të vazhdueshme nëse ka nevojë, ndaj nëse nuk ka plotësime apo propozime për ndryshimin e këtij plani, sugjeroi që pas diskutimeve të miratohet plani.

Besa Gaxherri pasi që nuk ka qenë prezente në mbledhjen e kaluar të komisionit tha se plani i punës në sesionin pranveror as përafërsisht nuk është përmbushur ngase komisioni ka punuar vetëm atë sa ka dërguar ligje qeveria e cila me punën e sajë ka treguar joefikasitet total, ajo numëroi disa çështje p.sh. kërkesat rreth ligjit të miratuar për kompleksin “Adem Jashari” nuk janë plotësuar siç janë vizita në atë kompleks, ankesat e bujqve kanë ngelur të pa plotësuar, ankesat e qytetarëve rreth ushqimit të përditshëm (mishi, mielli, qumështi) poashtu vetëm shtohen dhe asnjë nuk zgjedhën, importet e produkteve ushqimore hyjnë pa kontroll dhe janë të dëmshme, asnjë hap pozitiv nuk është bërë marr në përgjithësi, prandaj edhe plani për sesionin vjeshtorë i këtij komisioni është tejet e ngarkuar dhe ambicioz, çka do të thotë se komisioni duhet ti rendisë për këtë tremujor vetëm obligimet që duhet gjithsesi të kryhen dhe mund të kryhen. **Kryetari** ndërhyri dhe potencoi se ky komision nuk ka obligime nëse qeveria nuk është aktive, kurse rreth kërkesave jo të realizuara propozoi qysh në javën që vjen të realizohet vizita në kompleksin “Adem Jashari”, gjithashtu pyeti deputeten çka sugjeron ajo rreth përmirësimit të ushqimit të popullatës. **Deputetja Gaxherri** potencoi se LDK në shumë çështje do të përgjigjet përmes platformës qeverisëse për qeverinë e ardhshme që do ta prezantoi gjatë këtyre ditëve, për Komplexin Memorial Adem Jashari tha se kemi bërë një ligj dhe se Qeveria nuk ka bërë asgjë por edhe ne si komision së paku se kemi realizua një vizitë atje për me pa gjendjen reale, për subvencionet tha se nuk duhet asgjë më shumë se të kërkohet të zbatohet ligji.

Ganimete Musliu, i përsëriti kërkesat nga mbledhja e kaluar në lidhje me planin e punës: të planifikohet një vizitë e Komisionit në muzeun e Jasharajve në Prekaz; të ftohet drejtori i ri i Agjencisë së Komplekseve Memorialë në Komision për informim rreth planit dhe kërkesat e tyre për këtë kompleks, sepse tani është koha e përgatitjes së buxhetit për vitin e ardhshëm dhe komisioni të jetë i përgatitur për mbështetje të nevojave të kësaj agjencie; të bëhet një listë e projektligjeve dhe të kërkohet nga qeveria të vijë në afat të duhur; vizitë në Shqipëri në lidhje me shkëmbimin e përvojave; rreth skandalit të mishit në AUV, Kuvendi ka nxjerrë një rezolutë dhe komisioni është mirë të vizitohet AUV të njoftohet se çka është ndërmarr lidhur me këtë çështje.

Në vazhdim **Kryetari** konstatoi se diskutimet zhvillohen në drejtimin të votohet apo jo plani i punës sot përkundër faktit se ai para një jave ka shtyer këtë pikë për plotësime eventuale, sugjeroi mundësinë e futjes në agjendë të Komisionit një vizitë në Prekaz dhe pastaj të ftohet drejtori i Agjencisë së Memorialeve në komision, vazhdoi **Salih Zyba** me konstatimin se baza ligjore e agjendës legjislative gjendet në Qeveri dhe komisioni asgjë nuk mund të ndikoi edhe nëse harton plane. **Salih Salihu** tha se asgjë nuk arrihet me shtyrje, përkundrazi kërkesat janë të qarta dhe plani mund të votohet dhe të filloi komisioni të realizoi atë duke përkujtuar se komisioni është i obliguar në këtë fazë të kryej edhe dy monitorime të ligjeve, të çartësoi çështjen e subvencioneve dhe grandeve, të realizoi përfundimisht vizitën në Shqipëri si një interes i domosdoshëm, përndryshe do të mbetet komisioni pa agjendë, megjithatë **Salih Zyba** iu kundërvu disa kërkesave ngase sipas tij ende nuk janë kryer punët në komision, p.sh. nuk ka përgjigje nga ministria e bujqësisë për shumë çështje të ngritura me ministrin të takimin me të. **Besa Gaxherri** përsëriti se plani është i ngarkuar tepër, për çka **Kryetari** tha se nuk do të thotë që ajo në këtë sesion të realizoi të gjitha të shkruarat, ndaj edhe një herë pyeti komisionin të votohet plani sot apo edhe një javë të pritët për plotësime eventuale apo sqarime. **Z. Zyba** kërkoi që kryetari mos të krijoj praktikë të etablimit në komision të qëndrimeve të tija personale, kurse **Ganimete Musliu** apeloi për mospolitizim të çështjes por thjeshtë të shtyhet kjo pikë edhe një javë, me të cilin konstatim edhe **Kryetari** përfundoi këtë pikë.

Kryetari përfundoi këtë pikë tha se plani i punës të shtyhet edhe njëherë për mbledhjen e radhës dhe të dërgohen me shkrim idetë dhe propozimet me qëllim që të plotësohet ky plan.

5. Te ndryshme

Kryetari z. Nitaj pasi pyeti për çështje të ndryshme, **Salih Zyba** konstatoi se raporti i ministrisë së bujqësisë bashkë me ministrin në takimin me komisionin nuk mjaftojnë, ende nuk kanë dërguar përgjigjet shtesë të kërkuara nga komisioni sidomos për dëmet e shkaktuara, si shembull ofroi çështjen e mbrojtjes së fermerëve Kosovar nga breshëri duke pyet si mund të kërkojmë eksperiencën në Shqipëri nëse ministri ynë thotë që KFOR-i nuk lejon që Kosova të ketë këtë sistem kundër breshëritë. Sqarimet, vazhdoi ai, duhet të konsistojnë në faktin që për përcaktimin e kompensimeve ose subvencioneve a e kanë fjalën e fundit komunat apo ministria, dmth komuna vendos për prioritet se kush përpara kompensohet: amvisëria apo bujqësia, apo dikush tjetër, përndryshe lind pyetja ku shkojnë prioritetet nëse nuk përfundojnë.

Kryetari angazhoi stafin të përgatit këto dy pyetje me shkrim për Ministrin e bujqësisë përkatësisht ministrin Rikallo, të kërkohej përgjigje me shkrim, se cilat janë pengesat që Kosova të ketë një sistem ajror të mbrojtjes kundër breshërit dhe raport më të gjerë duke përfshirë edhe dëmet e mëvonshme në bujqësi si dhe kompensimin e dëmeve. Gjithashtu konstatoi që secili anëtarë i komisionit personalisht është autoritativ të kërkojë sqarime jo vetëm në MB por kudo rreth çështjeve nga fusha e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14,10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj